



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-276/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Fenuxar 69 EW i prodhuesit “Ciech Sarzyna S,A ”, Poloni nga përfaqësuesi i saj “Agrounion” SH.P.K, Fushë Kosovë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Fenoxaprop-p-ethyl.....60g/kg

4. PËRDORIMI:

Fenuxar 69 EW është një herbicid në formën e emulsionit vajor, i destinuar për luftimin e barërave të këqija njëvjeçare në elbin pranveror dhe gurin dimëror. Sipas klasifikimit HRAC, substanca aktive fenoksaprop-p-ethyl bënë pjesë në grupin A. Produkt i destinuar për trajtim me spërkatëse manuale ose spërkatëse të montuar në traktorë (atomizërë).

Fenuxar 69 EW është herbicid selektiv me veprim sistemik, i cili merret përmes gjetheve dhe zhvendoset në pjesët e tjera të bimëve d.m.th. në konet dhe majat e rritjes së lastarëve. Në bimë, ai frenon enzimën karboskilazë të acetyl koenzimës A (ACCazy) e cila merr pjesë në procesin e biosintezës së acideve yndyrore. Simptomat varen nga kushtet atmosferike, ato janë të dukshme 2-4 javë pas përdorimit. Simptoma e parë është ngecja në rritje, pastaj shpesh antocianin ose klorozë dhe gjethe të kuqërremta. Tharja dhe vdekja e tërësishme e bimëve ndodh nga maja e rritjes.

Fenuxar 69 EW lufton në mënyrë më efektive barërat monokotile nga faza e kotiledonit deri në fazën e shumimit, pavarësisht nga faza e zhvillimit të kulturës:

a) Përdorimi i produktit individualisht:

Elb pranveror

Barërat e këqija të ndjeshme: Tërshëra e egër (AVEFA)

Grurë dimëror

Barërat e këqija të ndjeshme: Aperë kallierë (APESV)

b) Përdorimi i produktit në përzierje me MCPA:

Elbi pranveror

Barërat e këqija të ndjeshme: Aperë kallierë (APESV), Ngjitës rrodhe (GALAP), Muhar (ECHCG), Minueri i bardhë (CHEAL), Kamomili i egër (MATIN), Fallopija dredhëz (POLCO), Veronikë arash (VERAR), Stellara e ndërmjetme (STEME).

Barërat e këqija mesatarisht të ndjeshme: Manushaqe arash (VIOAR).

a) Përdorimi i produktit individualisht:

Elbi pranveror, grurë dimëror

Koha e aplikimit: Në fazën e vëllazërimit, në shkallën (BBCH 22-33).

Norma e rekomanduar për aplikim: 1,0L/ha.

Numri maksimal i trajtimeve në të njëjtën fushë gjatë një vegjetacioni: 1 herë.

Sasia e rekomanduar e ujit: 200-300L/ha.

b) Përdorimi i produktit duke i shtuar me MCPA

Elb pranveror

Koha e aplikimit: Në fazën e vëllazërimit, në shkallën (BBCH 22-33).

Norma e rekomanduar për aplikim: Fenuxar 69 EW 1,0L/ha + MCPA 2,0L/ha.

Numri maksimal i trajtimeve në të njëjtën fushë gjatë një vegjetacioni: 1 herë.

Sasia e rekomanduar e ujit: 200-300L/ha.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

0.5L, 1L, 5L, 10L, 20 L, 220L

6. VËREJTJE:

Përpara aplikimit të produktit, është e nevojshme të njoftohen të gjitha palët e interesuara, të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj rrjedhjes së lëngut të punës dhe që kanë kërkuar një njoftim të tillë.

Masat paraprake për përdoruesit e produktit: Vëshni dorëza mbrojtëse, mbrojtje për sytë dhe fytyrën dhe veshje mbrojtëse nga efektet e dëmshme të produktit për mbrojtjen e bimëve dhe këpucë të përshtatshme gjatë përgatitjes së lëngut të përdorshëm dhe gjatë aplikimit dhe kur hyni në zonën e trajtuar. Lani duart tërësisht pas përdorimit të produktit. Hiqni rrobat e kontaminuar dhe lajini përpara ripërdorimit. Mos e ndotni ujin me produktin ose paketimin e tij. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor.

Shmangni kontaminimin nëpërmjet kanaleve të kanalizimeve nga oborret e fermave dhe rrugët. Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një zonë tampon të pa spërkatur prej 1m ndaj trupave ujorë sipërfaqësorë. Për të mbrojtur bimët jo të synuara, respektoni një zonë tampon të pa spërkatur prej 5m ndaj tokës jo bujqësore. Mbajeni larg fëmijëve.

Ruani produktin për mbrojtjen e bimëve: në vende ose objekte ku respektohen masat e duhura që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe parandalojnë aksesin e palëve të treta. Në paketimin origjinal, në mënyrë që të parandalohet kontakti me ushqimin, pijet ose ushqimet për kafshë,- ruhet në temperatura ndërmjet 0°C dhe 30°C- në enë të mbyllur. Mos ripërdorni paketimin bosh të produkteve për mbrojtjen e bimëve për qëllime të tjera. Hidhni produktin e papërdorur nëpërmjet subjekteve të autorizuar për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme. Në rast dyshimesh lidhur me menaxhimin e paketimit, kërkoni këshilla nga shitësi i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

7. KARENCA:

Karenca: është e siguar nga koha e aplikimit ne grurë dhe elb.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar ne Databazën e Pesticideve te BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Faton Peci
Ministër

Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*